




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-6795/25 datë:28.03.2025



Npi – 01/117 datë: 01.04.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 01.04.2025, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -III- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 01.04.2025 (e martë) në ora 9:00 h. në sallën e madhe të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, dhe z.Arton Demiri. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtori: z.Besnik Ahmeti – DBF; Zyrtari për Komunitete dhe Kthim z.Muhamet Mehmeti si dhe znj.Vlora Hyseni, zyrtare për informim. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm prej 4 anëtarëve prezent, mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 21.02.2025,
2. Rishikimi i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025 Npi - 01/23 datë: 27.01.2025, sipas Rekomandimit të Ministrisë së Shëndetësisë - Nr.05-1376 dt.25.02.2025,
3. Pasqyrat Financiare per vitin 2024,
4. Propozim per ndarjen e te hyrave te bartura nga viti 2024 per vitin 2025,
5. Shqyrtimi i Rekomandimeve Npi-01/60 date: 13.03.2025 të Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes,
6. Shqyrtimi i Rekomandimeve Npi-01/109 datë:26.03.2025 të Komisionit për ndarjen e çmimit "Nderi i Qytetit" të komunës së Shtimes,
7. Diskutim mbi plotësimin e komitetit për komunitete pas dorëheqjeve dhe hapat e mëtejshëm për zëvendësimin e anëtarëve,
8. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Unë propozoj që e me u hjekë pika e 5 e rendit të ditës me arsyetimin se nuk mund ta miratojmë si pako, sepse kemi, vërejtjet tona te disa rekomandime të Komisionit.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Unë realisht këtë pikë e kam futë qëllimisht në rendin e ditës, me arsyetimin që të diskutojmë për sa i përket emërimit të një segmenti të rrugës që lidhet në fund me rrugën “Hysiqi” me emrin “Shefki Osmani”. Po ashtu unë kamë menduar që ta diskutojmë një rekomandim për Kuvendin si Komitet për Komunitete, meqenëse arsimtari dhe aktivisti, tani i ndjerë Shefki Osmani i ka takuar komunitetit Ashkali.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 21.02.2025

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 21.02.2025.**

Pika 2

Rishikimi i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025 Npi - 01/23 datë: 27.01.2025, sipas Rekomandimit të Ministrisë së Shëndetësisë - Nr.05-1376 dt.25.02.2025

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Materialin po besoj e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, prandaj unë nuk do të lëshohem në detaje por në pikat kryesore. Pra e kemi pranuar një Rekomandim nga Ministria e Shëndetësisë, për me i larguar disa çmime të shërbimeve shëndetësore nga Rregullorja Komunale për Taksa për vitin 2025, dhe me harmonizuar me normat e Udhëzimit Administrativ Nr.03/2024 për bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore. Konkretisht këtu po bëhet fjalë për shërbimin paleativ të QKMF-së, që ne do ta kryejmë vullnetarisht, pa pagesë.

*** Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi ndryshimet në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, me numër Npi – 01/23 të datës: 27.01.2025, sipas Rekomandimit të Ministrisë së Shëndetësisë – Nr.05-1376 dt.25.02.2025.**

Pika 3

Pasqyrat Financiare per vitin 2024

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Edhe për këtë pikë materialin e keni pranuar me kohë, dhe e keni lexuar. Unë do ti lexoi pikat kryesore nga dokumenti (shih dokumentin). Buxheti i Alokuar në vitin 2024 ka qenë 11,361,029.00 € edhe pse Buxhetin e miratuar në Kuvend e kemi pas 9,906, 819.00 €. Buxheti për vitin 2024 është shpenzuar 97.2%. Borgji i Komunës është 21,000 € ky është borgji më i vogël që ka pas ndonjëher Komuna e Shtimes. Nëse ka dikush ndonjë pyetje konkrete do të përgjigjem.

z.Besnik Seferi: Te obligimet e Komunës, a mundesh drejtor me na dhënë krahasimet me vitet paraprake?

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Të dhënat që po i kërkon nuk i kam në dispozicion këtu për të bërë krahasimet, mirëpo mund të them që obligimet kryesore janë ato që dalin nga Kontrata Kolektive. Dhe siç e thash janë borgjet më të vogla që ndonjëher ka pas Komuna e Shtimes.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -III- për vitin 2025, të mbajtur më: 01.04.2025, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi raportin për Pasqyrat Financiare për vitin 2024.**

Pika 4

Propozim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2024 për vitin 2025

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Edhe për këtë pikë materialin e keni pranuar me kohë, dhe e keni lexuar. Meqenëse ky propozim vendim nuk ka shumë material po e lexoi krejt. (Shih dokumentin) Ne i kemi propozuar 13 pika se ku duhet të shkojnë këto mjete, normalisht që vendin e parë e nxanë projektet që janë në vazhdim, dhe pastaj për projekte të reja. Nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Arton Demiri: Përshëndetje. Desha ta pyes drejtorin për sa i përket projektit për banesat kolektive në komunën e Shtimes, se deri ku ka arritur kjo çështje e këtijë projekti për banim të përballueshëm?

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Sa i përket të hyrave të bartura, në këtë rast nuk kemi ndarë ndonjë shumë për këtë destinim.

z.Besnik Seferi: Sa i përket kësaj çështje, kemi shumë çka të diskutojmë, psh. për një fushë të futbollit në Lagjen e Pajtimit, por mendoj se nuk është kompetencë e drejtorit për të na dhënë sçarime këtu për këtë projekt por gjithsesi që do ta diskutojmë në Kuvend.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Pse po i vendosim këto pika në rendin e ditës në Komitetin për Komunitete është sepse është e preferueshme që pikat e Kuvendit me kaluar edhe nëpër mbledhjet e KPK-së sepse është komitet obligativ.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Te Drejtoria për Shërbime Publike i kemi ndarë disa mjete për arsye të formimit të Kompanisë së re publike në komunën tonë, e të cilën do ta mbështesim në fillimin e sajë.

z.Arton Demiri: E kamë edhe një pyetje për drejtorin, se a është planifikuar asfaltimi i rrugës “Shefket Muhadini”?

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Sa i përket asfaltimit të rrugëve të gjitha këto dhe çështje të tjera infrastrukturore mund ti shtrojmë me miratimin e buxhetit për vitin e ardhshëm.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -III- për vitin 2025, të mbajtur më: 01.04.2025, unanimitisht vendosi që t’i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi e Vendimit për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat në vitin 2024 për vitin 2025.**

Pika 5

Shqyrtimi i Rekomandimeve Npi-01/60 date: 13.03.2025 të Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Këtë e kemi futë si pikë të rendit të ditës për arsye se unë si Kryesues, në diskutim me familjen kemi propozuar që një rrugë në komunën e Shtimes të emërtohet me emrin e arsimtarit dhe aktivistit “Shefki Osmani”. Kjo rrugë gjindet gati në fund të rrugës “Hysiqi” në Shtime.

z.Besnik Seferi: Unë nuk jam “Për” që të shkohet për votim në paket, sepse ka disa rekomandime të Komisionit me të cilat unë nuk pajtohem. Mirëpo sa i përket propozimit për emërtimin e ndonjë rruge me emrin “Shefki Osmani” unë jamë “Për”, dmth. vetëm sa i përket propozimit të Kryesuesit për këtë rrugë.

z.Arton Demiri: Edhe unë jamë “Për” emërtimin e këtijë segmenti të rrugës me emrin e arsimtarit “Shefki Osmani”.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -III- për vitin 2025, të mbajtur më: 01.04.2025, unanimitisht vendosi që t’i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi vendimin për emërtimin e segmentit në fund të rrugës “Hysiqi” në anën e majtë, me emrin “SHEFKI OSMANI”.**

Pika 6

Shqyrtimi i Rekomandimeve Npi-01/109 datë:26.03.2025 të Komisionit për ndarjen e çmimit "Nderi i Qytetit" të komunës së Shtimes

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani: Përshëndetje. Meqenëse unë kamë qenë anëtare e Komisionit për ndarjen e çmimit "Nderi i Qytetit" po jap disa sçarime. Ne në Komision i kemi shqyrtuar dy propozimet e Kryetarit për ndarjen e çmimit "Nderi i Qytetit" ku janë propozuar Prof.Fadil Hysaj dhe Prof.Ismajl Hasani (post mortum). Kandidati Prof.Ismajl Hasani (post mortum) përveq kontributit në fushën e shkencës dhe edukimit të brezit të ri, ai ishte i angazhuar edhe politikisht, ku kishte kandiduar edhe për Kryetarë të Komunës së Shtimes. Kandidati tjetër Prof.Fadil Hysaj, edhe ky ka dhënë një kontribut të madh edhe për Shtimen por edhe shumë më gjerë në fushën e Kulturës. Përveq shumë veprave të tijë artistike, filmike, duhet përmendur angazhimin e tijë në organizimin e festivalit ndërkombëtar "Etno-Fest".

z.Besnik Seferi: Edhe unë i përkrahu që të dy kandidatët sepse janë meritore dhe do ti votoj.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -III- për vitin 2025, të mbajtur më: 01.04.2025, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratojë vendimin për ndarjen e çmimit "Nderi i Qytetit" për kandidatët: Fadil Hysaj - Shtime dhe Ismajl Hasani – Shtime (Post mortum).**

Pika 7

Diskutim mbi plotësimin e komitetit për komunitete pas dorëheqjeve dhe hapat e mëtejshëm për zëvendësimin e anëtarëve

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Siç e dini tani më në Komitetin për Komunitete po na mungojnë dy anëtarë të Komitetit. Më parë ka dhënë dorëheqje znj.Shkurte Behluli për arsyet e saja personale. Dha tash së fundi po ashtu ka dhënë dorëheqje edhe z.Muhamet Mehmeti, për arsye të punësimit të tijë si shërbyes civil në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim. Po ashtu ndonjëher po kemi problem edhe me mosprezencën e znj.Shkurte Mustafa. Kështu që me këto mungesa normalisht që kemi problem për në punë cilësore të Komitetit.

z.Besnik Seferi: E vërtetë që po kemi vështërsi për punën e KPK-së. Meqenëse ky Komitet është obligativ, është me rëndësi që ta diskutojmë edhe prezencën e anëtarëve në mbledhje, sepse është shumë e lehtë që mos ta kemi kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Në mbledhjen e Kuvendit do të kërkojmë që të plotësohet Komiteti për Komunitete. Unë propozoj që ti rekomandojmë Kryesuesit të Kuvendit që ta procesojë shpejt zgjedhjen e anëtarëve të KPK-së.

znj.Rrezartë Ramadani: Më në fund paskan ardhur edhe propozimet nga partit politike për ta plotësuar Komitetin me anëtarë të ri. E mirëpresim zgjedhjen e anëtarëve të ri të Komitetit.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Unë nuk kisha dashur me hy me emra të përvetshëm, por që ti rekomandojmë Kryesuesit që të vendosë në mbledhjen e ardhëshme për plotësimin e Komitetit me anëtarët e ri.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -III- për vitin 2025, të mbajtur më: 01.04.2025, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Shtimes që në mbledhjen e radhës të vendos si pikë të rendit të ditës "Zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit për Komunitete".**

Pika 8

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Arton Demiri: Më datën 08.04.2025, komuniteti Rom e feston ditën e Flamurit. Ju ftoj të gjithë anëtarëve të Komitetit për Komunitete, por edhe pjesëmarrsit tjerë këtu në mbledhje, që të vini në manifestimin tonë i cili do të mbahet më datën 08.04.2025 në ora 12:00h te restoranti "EBI" në

Shtime. Kam edhe një propozim që Sherif Jasharit nga Shtimja nga komuniteti Ashkali, propozoj që me i ndihmuar për me ja siguruar qiranë për banim, sepse ai i ka gjendjen shumë të vështirë.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Urime për ditën e flamurit 8 Prill 2025. E përgëzoj Komunën e Shtimes që po e përkrahë këtë ditë. Pyetja është se a është ky Sherif Jashari banorë i komunës së Shtimes, sepse sa e di unë ky ka jetuar në Lipjan.

z.Besnik Seferi: Unë e njoh këtë person. Ky ka lëvizur herë në Lipjan e herë në Fushë Kosovë e herë në Shtime. Ai nuk është banorë rezident i komunës së Shtimes, kjo është diskutabile, mirëpo si rast mund të them se është mjaft i rëndë.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Ndoshta ka mundësi që me i ndihmu pak me anë të ndonjë iniciative qytetare. Meqenëse ky nuk qenka banorë i komunës së Shtimes ne nuk mund të krijojmë presedan dhe pastaj të hapet rruga edhe për shumë njerëz të tjerë.

z.Muhamet Mehmeti, zyrtar i ZKKK: Përshëndetje. Sa i përket Sherif Jasharit, ky nuk ka vendqëndrim të përhershëm, ky lëviz varësisht se si i konvenon. Ky nuk është banorë i komunës së Shtimes. Ndihamat Sociale i merr në Komunën e Lipjanit. Sa i përket pagesës së qirasë ajo bëhet vetëm për banorët e komunës së Shtimes. Ne kemi problem edhe me fëmijët e tij për të vazhduar shkollimin fillor. Do të shikojmë mundësinë ligjore nëse ka mundësi me ja pagu disi qiranë për 5 muaj.

znj.Rrezartë Ramadani: Unë mendoj se do të ishte mirë që ne si Komitet me pas një Informatë nga ZKKK-ja për muajin Prill-2025, dhe pastaj do ta kishim mundësinë për me diskutuar lidhur me informatën.

z.Besnik Seferi: Po ZKKK-ja është e obliguar që të na ofroj informatë për punën mujore të sajë.

z.Muhamet Mehmeti, zyrtar i ZKKK: Nuk është kjo fare problem, unë e përgatiti një informatë dhe jam i gatshëm të përgjigjem në pyetjet e juaja.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Atëherë po besoj se në mbledhjen e radhës do të kemi një informatë nga ZKKK-ja. Unë ju falënderoj për kontributin e juaj dhe meqenëse diskutime të tjera nuk ka mbledhjen e përfundoj në ora 16:05h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

